



Prishtinë, 20.12.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1082_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Rregullën dhe Metodologjinë për Hartimin e Bilanceve të Energjisë; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. të datës 19 nëntor 2018, për miratimin e dokumentit: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2019-2028.

Pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET BILANCI AFATGJATË I ENERGISË TERMIKE** për periudhën 2019-2028 i NQ Gjakova sh.a.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar draftin final të dokumentit: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike për periudhën 2019-2028 nga NQ Gjakova sh.a. si bartës i Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.
2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2019-2028" të dorëzuar nga NQ Gjakova dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi menjëherë të publikojë dokumentin "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2019-2028" në faqen elektronike zyrtare të tij.
- III. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të monitoroj implementimin e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.



- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
- VI. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike – 2019-2028, NQ Gjakova

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së